

VENDIM Nr. 347, datë 19.06.2025
PËR
KRIJIMIN E BAZËS SË TË DHËNAVE SHETËRORË “REGJISTRI ELEKTRONIK
I NËPUNËSVE TË MBROJTJES SË TË DHËNAVE PERSONALE”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 4, të ligjit nr.10325, datë 23.9.2010, “Për bazat e të dhënave shetërore”, me propozimin e ministrit të Drejtësisë, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

I. Krijimin, pranë institucionit të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (në vijim, KDIMDHP), e bazës së të dhënave shetërore “Regjistri elektronik i nëpunësve të mbrojtjes së të dhënave personale” (në vijim, RENMDHP), përmbajtja e së cilës publikohet në faqen zyrtare të internetit të KDIMDHP-së.

II. KDIMDHP-ja është përgjegjëse për krijimin, mbajtjen, administrimin, ndërveprimin me bazat e tjera dhe bërjen të disponueshëm të informacionit, në përmbajtje të bazës së të dhënave “Regjistri elektronik i nëpunësve të mbrojtjes së të dhënave personale”.

III. RENMDHP-ja përmban të dhëna për nëpunësit e mbrojtjes së të dhënave personale (në vijim, NMDHP), caktuar nga kontrolluesit dhe përpunuesit.

IV. Të dhënat që përmban RENMDHP-ja ndahen në të dhëna parësore dhe në të dhëna dytësore, si më poshtë:

1. Të dhëna parësore janë:

- a) të dhënat mbi NMDHP-në;
- b) adresa e postës elektronike;
- c) adresa e ushtrimit të veprimtarisë;
- ç) numri i kontaktit;
- d) të dhënat mbi kontrolluesit/përpunuesit, ku është caktuar NMDHP-ja;
- dh) trajnimet dhe certifikatat e NMDHP-së, në fushën e mbrojtjes së të dhënave personale.

2. Të dhëna dytësore janë ato të dhëna që merren nga ndërveprimi me bazat e të dhënave shetërore, si më poshtë vijon:

a) Nga Regjistri Kombëtar i Gjendjes Civile merr të dhënat e mëposhtme:

- i. Emrin dhe mbiemrin e NMDHP-së;
- ii. Numrin personal të NMDHP-së.

b) Nga Regjistri Tregtar i QKB-së merr të dhënat e mëposhtme:

- i. NIPT-in e kontrolluesit/përpunuesit;
- ii. Adresën e postës elektronike zyrtare të kontrolluesit/përpunuesit;
- iii. Adresën e kontrolluesit/përpunuesit;
- iv. Numrin e telefonit të kontrolluesit/përpunuesit.

c) Nga Regjistri Elektronik Kombëtar i Organizatave Jofitimprurëse merr të dhënat e mëposhtme:

- i. Të dhënat e identifikimit të organizatës jofitimprurëse;
- ii. Adresën e postës elektronike zyrtare të kontrolluesit/përpunuesit;
- iii. Adresën e kontrolluesit/përpunuesit;
- iv. Numrin e telefonit të kontrolluesit/përpunuesit.

V. Dhënësi i informacionit për RENMDHP-në është KDIMDHP-ja.

VI. Niveli i aksesit në sistemin dhe në bazën e të dhënave të RENMDHP-së është, si më poshtë vijon:

1. Qytetarët (subjekte të të dhënave personale) kanë nivel aksesit si lexues dhe konsultues lidhur me informacionin e vënë në dispozicion nëpërmjet faqes së internetit të KDIMDHP-së;

2. NMDHP-të dhe kontrolluesit e përpunuesit publikë dhe privatë kanë të njëjtin nivel aksesit si ai i parashikuar në pikën 1 të kësaj ndarjeje.

3. KDIMDHP-ja ka akses si administrator dhe përdorues në RENMDHP. Niveli i aksesimit, funksionet dhe të drejtat për secilën kategori konsultuesish dhe përdoruesish të sistemit, si dhe për punonjësit e KDIMDHP-së janë në përputhje me pozicionin e punës dhe përcaktohen në rregulloren “Për sigurinë e bazave të të dhënave shtetërore të krijuara në KDIMDHP”, miratuar nga Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale.

VII. Të gjitha ndryshimet në arkitekturën software dhe hardware të RENMDHP-së në KDIMDHP, të cilat mund të ndodhin në varësi të nevojave të institucionit dhe praktikave evropiane e ndërkombëtare në fushën e mbrojtjes së të dhënave, bëhen në përputhje me legjislacionin në fuqi.

VIII. “Regjistri elektronik i subjekteve kontrolluese” vijon të funksionojë si “Regjistri elektronik i nëpunësve të mbrojtjes së të dhënave personale”, në përputhje me këtë vendim, duke bërë ndryshimet përkatëse.

IX. Vendimi nr.144, datë 13.3.2018, i Këshillit të Ministrave, “Për krijimin e bazës së të dhënave shtetërore “Regjistri elektronik i subjekteve kontrolluese””, shfuqizohet.

X. Ngarkohet Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në “Fletoren zyrtare”.

K R Y E M I N I S T R I

EDI RAMA

Në mungesë dhe me porosi

ZËVENDESKRYEMINISTRI

BELINDA BALLUKU